



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 29 Prot.

Tiranë, më 25 / 01/ 2012

Lënda: Komente mbi projektligjin “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” .

Drejtuar: Z. Myqerem TAJAJ
MINISTËR I ARSIMIT DHE SHKENCËS

TIRANË

I nderuar Z. Ministër,

Në përgjigje të shkresës Tuaj me nr. 6700 prot, datë 22.12.2011 me anë të së cilës kërkohet mendim për projektligjin “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, pasi u njohëm me draftin e përgatitur komentet tona janë si më poshtë:

Së pari, konstatojmë se në ripunimin e projektligjit janë pasqyruar rekomandimet tona për nenin 36 të draftit të mëparshëm të këtij ligji, i cili kufizonte lirinë në ushtrimin e fesë. Ky kufizim cënon të drejtën për arsim, për shkak të përkatësis fetare.

Së dyti, konstatojmë se një vëmendje e veçantë i është kushtuar në pikën 6, të nenit 6 me titull “Parime të Përgjithshme”, dhe në nenin 19 me titull “Përkujdesje për kategori të veçanta të nxënësve”, sanksionimit të detyrimit të shtetit për kujdesje të posaçëm për kategori të veçanta të nxënësve.

Në këtë drejtim, pavarësisht se në projekt ligj nuk janë parashikuar shprehimisht nëse në kategorinë e nxënësve të familjeve në nevojë përfshihen kategoria e nxënësve romë apo e



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

nxënësve të prekur nga HIV/AIDS, të përcaktohen në mënyrë të qartë që me akte nënligjore në vijim, kujdesi i posaçëm i shtetit për këto dy kategori.

Arsimimi i fëmijëve të komunitetit rom vazhdon të mbetet një çështje kritike dhe niveli i arsimimit të tyre është i ulët. Kujdesi i posaçëm për këtë kategori nxënësish do të përshpejtonte vendosjen e barazisë, pabarazi e cila është shkaktuar si rezultat i diskriminimit të cilit i është nënshtruar kjo kategori për shkak të përkatësisë në këtë minoritet.

Po ashtu, nga ana tjetër një kujdes i posaçëm duhet të sigurohet edhe për nxënësit e prekur nga HIV/AIDS. Trajtimi i barabartë edhe pas konstatimit të sëmundjes është i rëndësishëm për mbështetjen psikologjike të këtyre fëmijëve.

Komisioneri rekomandon që në përcaktimin e kategorive të veçanta të nxënësve që do tu sigurohet një kujdes i posaçëm nga shteti, me qëllim përshpejtimin e barazisë në arsim, të mbahen parasysh përcaktimet që bëhen në nenin 18¹ të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin.

Irma BARAKU



Konc: Amarda Coku, Specialiste DÇPLMJ
Klodiana Kamberaj, Specialiste DÇPLMJ

¹ Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës janë secili përgjegjës për marrjen e masave me karakter pozitiv për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim.

2. Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës, ndër të tjera, marrin secili masa për:

- a) rritjen e ndërgjegjësimit për këtë ligj në sistemin arsimor, ndër të tjera duke përfshirë informacion për të në programet mësimore;
- b) përfshirjen në programet mësimore të koncepteve dhe veprimeve kundër modeleve të sjelljes diskriminuese;
- c) arsimimin e të gjithë popullsisë në mënyrë të veçantë, duke marrë masa në favor të grave dhe vajzave, pakicave, personave me aftësi të kufizuara, si dhe personave që janë, ose kanë më shumë mundësi të jenë objekt i diskriminimit, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

ç) respektimin dhe sigurimin e së drejtës për arsimim në gjuhët e pakicave, si dhe në mënyrat e përshtatshme për persona me aftësi të kufizuara.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al